



Central Fiscal Authority



UDHËZIMI ADMINISTRATIV Nr. 02/2002, Datë 1 Prill 2002

MBI

ZBATIMIN E TATIMIT NË FITIM NË KOSOVË

Kryesuesi i Autoritetit Qendror Fiskal,

Nxjerr Udhëzimin Administrativ te meposhtem:

Neni 1
Perkufizime

Termi 'Rregullore' nënkupton Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/3, Datë 20 Shkurt 2002 'Mbi Tatimin në Fitim në Kosovë'.

Neni 2
Shpenzimet e lejuara

Që të njihen si shpenzime të zbritshme, të gjitha shpenzimet duhet të dokumentohen në tërësi dhe i gjithë dokumentacioni mbështetës, si kontratat, faturat, deklaratat doganore, kuponat, dokumentet e pagesës, dokumentet bankare, liste-pagesa, urdhër-transferimet dhe dokumente të tjera përkatëse duhet të jenë në dispozicion për inspektim sipas kërkesës.

Neni 3
Kostot e eksplorimit dhe zhvillimit

Neni 17 i rregullores parashikon amortizimin e një depozite natyrale të mineraleve dhe burimeve të tjera natyrore. Shfrytëzuesi i depozites mund të kërkojë zbritje për kostot e eksplorimit dhe zhvillimit.

Kostot e eksplorimit, kostot e zhvillimit dhe interesi i lidhur me to duhet të mblidhen në nje llogari kapitale ashtu sic kane lindur. Në fund të periudhës tatimore, pjesa e kostove të eksplorimit dhe zhvillimit që i përkasin asaj periudhe do të përcaktohet duke shumëzuar balancen në llogarinë kapitale me koeficientin e amortizimit (KA) që është:

Numri i njësive të nxjerra gjatë vitit
KA= _____

Totali i njësive të vlerësuara në deposite

Shembull: Një kompani ka marrë më qira një fushë bakri dhe se numri i vlerësuar i njësive në deposite është prej 15,000,000. Prodhimi për vit është 1,500,000 njësi. Balanci në llogarinë kapitale në fund të periudhës tatimore është prej 500,000 € Për të përcaktuar shumën e amortizimit të lejuar për periudhën

tatimore, balanci në llogari duhet të shumëzohet me koeficientin e amortizimit. Në këtë rast, koeficienti është 10% (1,500,000/15,000.000). Kështu amortizimi i lejuar si zbritje është 50,000 €

Për të përcaktuar numrin e vlerësuar total të njësive në deposite, tatimpaguesi duhet të marrë raportin nga ekspertët dhe duhet ta vejë në dispozicion për Administratën Tatimore për inspektim nëse i kërkohet apo si pjesë të deklaratës tatimore. Llogaritja e njësive të ekstraktit duhet të kryhet duke i shfrytëzuar në mënyrë gjenerale metodat e pranueshme. Administrata Tatimore ruan të drejtën të shfrytëzojë shërbimet e specialisteve të pavarur për të rishikuar raportet e inxhinjeringut dhe metodat e llogaritjes së ekstraktit.

Neni 4

Deklarata tatimore

Në përputhje me Nenin 28 të rregullores deklarata e tatimit në fitim duhet të dorëzohet në ndonjërin prej bankave të autorizuar më ose para 1 Prillit të vitit që pason periudhën tatimore. Deklarata tatimore është përgatitur në tri kopje origjinale. Kopja e parë dhe e dytë mbeten në bankë derisa e treta i kthehet tatimpaguesit mbasi të jetë vulosur nga banka. Deklarata tatimore do të konsiderohet si një vlerësim i bërë nga vete tatimpaguesi. Formulari i deklaratës tatimore së bashku me udhëzimet se si të plotësohet ajo do të determinohet në Udhëzimin Administrativ vijues.

Neni 5

Pagesat tremujore

Në lidhje me Nenin 29 të rregullores, çdo tatimpagues do të bëjë pagesat në keste tremujore për tatimin në fitim në ndonjërin prej bankave të autorizuar në Kosovë mbrenda 15 ditëve nga fundi i tremujorit. Nëse afati i fundit për të dorezuar formularin e pagesës në keste është fundjave apo festë, formulari do të dorëzohet në ditën e parë të punës që pason fundjavën apo festën. Shuma e pagueshme nëpërmjet kesteve tremujore do të jetë më e larta e:

- a) fitimi i vlerësuar për periudhën tatimore pjestuar me katër dhe shumëzuar me përqindjen tatimore, apo
- b) shuma e tatimit në fitim të vlerësuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kaluar tatimore, nëse ka, apo nëse nuk ka vlerësim nga Administrata Tatimore, shuma e deklaruar nga tatimpaguesi, pjestuar me katër.
- c) Për periudhën tatimore 2002 secili tatimpagues do të beje pagesa tremujore bazuar në fitimin e vlerësuar për 2002. Administrata Tatimore do të krahasojë të ardhurat e vlerësuara e të deklaruara për 2002 me të ardhurat e deklaruara apo të vlerësuara për Tatim të Paragjykuar apo Tatim në Vlerën e Shtuar në vitin 2001. Ndryshimet thelbësore do të hetohen automatikisht. Shpenzimet e vlerësuara poashtu do të rishikohen.

Formati i pagesës në keste është paraqitur më poshtë:



Central Fiscal Authority



TATIMI NE FITIM
FORMULARI I PAGESËS ME KESTE

[1] Periudha e deklarimit (Q/YYYY)

[2] Numri i regjistrimit të biznesit [3] Numri serik [2] PQ

[4] Emri i biznesit

[5] Adresa

Komuna Rruga Numri i rrugës Telefoni:

[6] Emri i pronarit [6] Telefoni:

[7] Vendors 'X' në kutinë e duhur nëse nuk deklaroni për të parën herë për këtë periudhë deklaruese.
Shtesë Përmirësim Pagesë shtesë

Table with 2 columns: Description and Code. Rows include: [8] Të ardhurat e vlerësuara për Periudhën Tatimore pjestuar me 4... f181; [9] Shpenzimet e vlerësuara për periudhën Tatimore pjestuar me 4... f191; [10] Fitimi i vlerësuar për Periudhën Tatimore pjestuar me 4... f1101; [11] Kësti tremujor [10] x 20%... f1111; [12] Tatimi në Fitim i vlerësuar për vitin e kaluar pjestuar me 4... f1121; [13] Pagesa e kështit që paguhet me këtë formular... f1121; [14] Tatimi i mbajtur nga Dividentët, te Drejta e Autorit, Interesin e paguar për jorezidentët të paguar me këtë formular (Plotëso tabelën A mbrapa)... f1141; [15] Pagesa e tërësishme me këtë formular [15]=[13]+[14]... f1151

(Vetëm Kompanitë e Sigurimit)

Table with 2 columns: Description and Code. Rows include: [16] Primet bruto për tremujor... f161; [17] Kesti tremujor [16] x 7%... f171

Deklaroj se të dhënat e sipërme janë të vërteta.
() dd/mm/vv

Table titled 'Informatat bankare të pagesës' with columns: Numri i llogarisë, Dega/Referenca e transferit, Nr., Euro, Vlera. It includes a grid for bank account details and a list of Euro denominations (1000, 500, 200, 100, 50, 20, 10, 5).

Tabela A

| Shuma e paguar për personat jorezident | Natyra e të ardhurave | | | Tatimi i mbajtur në Burim= 15% x (a)] | Vendi prej nga është personi jorezident |
|--|-----------------------|----------|--------------------|---------------------------------------|---|
| | Dividentët | Interesi | E drejta e autorit | | |
| a | b | C | d | e | f |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

Vendos totalin e kolonës 'e' në kutinë [14] te deklaratës tatimore.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi të njëjtën datë me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/03: më 1 Prill 2002.

Kryesuesi i Autoritetit Qendror Fiskal

Mike Ives